



Biblioteka Akadematike

Manual përdorimi

Universiteti “Eqrem Çabej”

Lagjia “18 Shatori”

Rruga “Studenti”

Godina nr.3

Gjirokastër

Shqipëri

Biblioteka Online <http://www.uogj.edu.al/index.php?page=biblioteka>

Plani i guidës:

- | | |
|--|-------|
| • Historiku i bibliotekës. | f. 2 |
| • Regjistrimi i përdoruesve të rinj. | f. 3 |
| • Si është klasifikuar fondi bibliotekar? | f. 5 |
| • Katalogu COBISS/OPAC; rrjeti i sistemeve bibliotekare informuese dhe sistemeve të informacionit. | f. 9 |
| • Burime të tjera për gjetjen e informacionit elektronik në bibliotekë. | f. 23 |
| • Aktivitete të organizuara nga Biblioteka Akadematike. | f. 24 |
| • Si kryhet pasurimi i fondit bibliotekar? | f. 28 |
| • Shfrytëzimi i hapësirës dhe fondit të bibliotekës. | f. 29 |

“Gjithmonë e kam imagjinuar parajsën si një lloj bibliotekë”

Jorge Luis Borges



1991 Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 12 Nëntor 1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, i çelur më 1971. Biblioteka Akademike, që me çeljen e ILP, ka kryer dhe vazhdon të kryejë funksionin e saj mbështetës si një strukturë kulturore dhe informuese në dispozicion të stafit studentor dhe akademik.

Biblioteka Akademike e Universitetit kryen funksionet e saj duke u bazuar në Ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin nr.9217, datë 08.04.2004 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", Kreu V, neni 30.

2002 Pati fillesat e tij krijimi i katalogut elektronik falë programit ABECT 5.5, ndihmë e Komisionit European.

2004 Falë dhurimit që shoqata zviceriane "Partner Fur Gjirokaster" (PFGJ) i bëri bibliotekës, u çel një seksion me tituj librash, shumica në letërsi, rreth 4000 vëllime në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht).

2005 Biblioteka kaloi në ambientet e reja të Godinës nr.3, ku ndodhet aktualisht.

2005 U krye shtrirja e rrjetit informatik në Universitet, gjë e cila mundësoi shfrytëzimin e internetit edhe në ambientet e bibliotekës.

2006 Fillon abonimi i Bibliotekës në revista shkencore, i cili bën të mundur nga ana e studentëve/pedagogëve të shfrytëzojnë literaturë on line.

2016 Ka nisur digjitalizimi i fondit bibliotekar me futjen në programin COBISS në të cilin janë anëtarë 32 biblioteka universitare dhe publike. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve në rrugë elektronike nëpërmjet Website-it të UGJ-së, ku gjendet seksioni: Biblioteka Online <http://uogj.edu.al/index.php?page=biblioteka>.

"Një bibliotekë është një spital i shpirtit".

REGJISTRIMI I PËRDORUESVE TË RINJ

- Procedura standarde që ndiqet nga punonjësi i Bibliotekës për regjistrime të reja:
 - Çdo përdorues i ri i Bibliotekës Akademike, që të plotësojë kartelën e regjistrimit për tërheqjen e literaturës përkatëse që merr në përdorim, duhet të paraqesë një mjet identifikimi (kartë identiteti/pasaportë);
 - Punonjësi i bibliotekës plotëson formularin e regjistrimit për të hapur kartelën personale të përdoruesit;

Figura 1: Kartela e regjistrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
 BIBLIOTEKA AKADEMIKE
 GJIROKASTËR

Nr. _____

KARTELË PERSONALE E PËRDORUESIT

Mbiemri _____

Emri _____

Atësia _____

Adresa e banimit _____

Nr. i dokumentit identifikues _____

Nr. i tel. _____

Fakulteti _____

Dega _____

Anëtar

()


Biblioteka

()

Gjrokastër, më _____ 20



[illegible]

- Përdoruesi mund të tërheqë librin duke bërë kërkesën e tij ose të zgjedhë vetë në raft dhe më pas, mund të ulet të lexojë në ambientet e bibliotekës; mund ta marrë me vete pasi punonjësi i bibliotekës e regjistron në kartelë. Afati kohor i dorëzimit është 7 – 14 ditë. Mund të rinovohet afati në rast se duhet të shtyhet, me kusht që, ajo literaturë të mos ketë rezervim tjetër. Ndërsa, veprat e referencës si: fjalorë, enciklopedi, biografi,



“Kam lexuar një libër një ditë dhe tërë jetën time kam ndryshuar”
Orhan Pamuk

bibliografi, atlase, vjetarë, janë vepra që kërkohen për një përdorim të shpejtë, të caktuar; ato përdoren kur bëhet një kërkim informacioni në mënyrën më objektive të mundshme.



- Në çdo vit akademik, përpilohet dhe përcillet lista me të dhënat e përdoruesve të rinj me qëllim shfrytëzimin e një shërbimi risi si ai i bibliotekës elektronike U – Library i cili, në bashkëpunim me operatorin global EBSCO, u bën të mundur këtyre përdoruesve aksesim falas të shërbimit të librarisë digjitale.

Figura 2: Përdoruesit e rinj të u – library:

No.	Emri i përdoruesit	Emri	Mbiemri	E-mail	Shërbimi
1	U. C. C. C.	ELIANA	ELIENAS	elienas@u.edu.al	Shërbimi
2	U. C. C. C.	ELIANA	ELIENAS	elienas@u.edu.al	Shërbimi
3	U. C. C. C.	ANASTASIA	ANASTASIA	anastasias@u.edu.al	Shërbimi
4	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
5	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
6	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
7	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
8	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
9	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
10	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
11	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
12	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
13	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
14	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
15	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
16	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
17	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
18	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
19	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
20	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
21	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
22	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
23	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
24	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
25	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
26	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
27	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
28	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
29	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
30	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
31	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
32	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
33	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
34	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
35	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
36	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
37	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
38	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
39	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
40	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
41	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
42	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
43	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
44	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
45	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
46	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
47	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
48	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
49	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi
50	U. C. C. C.	TRIANA	TRIANA	trianas@u.edu.al	Shërbimi

"leximi është një mënyrë tjetër për të qënë diku"

SI ËSHTË KLASIFIKUAR FONDI BIBLIOTEKAR?

- Fondi bibliotekar: është organizuar në bazë të vendosjes *sistematike* të tij, klasifikuar sipas rregullave universale të **UDC** (Klasifikimi Dhjetor Universal, KDU). Ky sistem klasifikimi, i zhvilluar më 1895 nga dy belgë, Paul Hotlet dhe Henri la Fontaine, ka për qëllim të bëjë një ndarje të librave sipas fushave të dijes njerëzore. Tabela është pasuruar dhe zhvilluar në kohë, p.sh., është shtuar *nëndarja 004: shkencat kompjuterike*, degë e shkencës që mori zhvillim të madh kohët e fundit.
- Për secilën nga këto fusha, është vendosur nga një numër (nga 0 tek 9) dhe çdo numër mund të ndahet në 10 nënfusha (nënklasa). Ky është rregulli i klasifikimit, pra, ky është klasifikimi kryesor.
- Klasifikimi i fushave të dijes dhe të shkencës sipas KDU-së:

0 Çështje të përgjithshme. Shkenca dhe dituria. Organizimi. Informacioni. Dokumentacioni. Shkrimi. Bibliografia. Bibliotekonomia. Institucionet. Dokumentet dhe botimet në përgjithësi.

1 Filozofia. Psikologjia. Logjika. Etika.

2 Feja. Teologjia

3 Shkencat shoqërore. E drejta. Qeveria.

Kjo degë mund të nëndahet në nëndarjet kryesore, në vartësi të literaturës që ka biblioteka si më poshtë:

31 Demografia. Sociologjia. Statistika.

32 Politika.

33 Ekonomia.

34 E drejta. Legjislacioni.

35 Administrata publike. Qeveria. Shkenca dhe arti ushtarak.

36 Përkujdesja shoqërore. Bamirësia. Koha e lirë.

37 Edukimi. Mësimdhënia. Përgatitja. Koha e lirë.

389 Metrologjia. Peshat dhe masat.

39 Etnologjia. Etnografia. Jeta shoqërore. Mënyrat e jetesës. Folklori.

4 I lirë

5 Matematika dhe shkencat e natyrës.

Mund të ndahet si më poshtë:

51 Matematika

52 Astronomia. Astrofizika. Kërkime hapsinore. Gjeodezia.

53 Fizika.

54 Kimia. Kristalografia. Mineralogjia.

55 Shkencat e tokës. Gjeologjia. Gjeofizika. Sizmologjia. Meteorologjia. Hidrologjia.

56 Paleontologjia.

57 Shkenca biologjike në përgjithësi. Virologjia. Mikrobiologjia.

“Po të më vinin te këmbët kurorat e gjithë mbretërive të botës në vend të librave të mi dhe të dashurisë për të lexuar, unë do t'i flakja të gjitha.” f. fenelon

- 58 Botanika.
59 Zoologjia
6 Shkencat e aplikuara. Mjekësia. Teknologjia.

Nëndahet si më poshtë:

- 61 Shkencat mjekësore në përgjithësi.
62 Inxhinieria. Teknologjia në përgjithësi.
63 Bujqësia. Shkencat dhe teknikat që lidhen me të. Pyjet.
64 Ekonomia shtëpijake. Shkenca shtëpijake. Drejtimi i ekonomisë shtëpijake.
65 Drejtimi dhe organizimi industrial, tregtar dhe i komunikacionit.
66 Teknologjia kimike. Industria kimike dhe industritë që lidhen me të.
67 Industritë e ndryshme. Zejet.
68 Industritë, zejet dhe tregtia për artikujt dhe grupet e artikujve të përfunduar.
69 Teknika e ndërtimit. Materiale ndërtimi. Praktika dhe proceset e ndërtimit.
7 Artet. Zbavitja. Argëtimi. Sporti.

Mund të nëndahet si më poshtë:

- 71 Planifikimi fizik. Planifikimi krahinor i qytetit dhe i fshatit. Peisazhet, parqet, kopshtet.
72 Arkitektura.
73/76 Artet figurative
77 Fotografia dhe proceset e ngjashme me të.
78 Muzika
79 Shlodhja. Zbavitja. Argëtimi
796/799 Sportet.
8 Gjuha. Gjuhësia. Letërsia.
81 Gjuhësia. Gjuhët
82 Letërsia

821.18 Letërsia shqipe. Për lehtësi në etiketë mund të përdoret 8Sh.

821.1/.9 Letërsia e huaj. Për lehtësi në etiketë mund të përdoret 8H

8F Letërsia për fëmijë.

Në qoftë se letërsia ndahet sipas gjinive, kjo pasqyrohet dhe në numrin e vendit, p.sh.:

8Sh-1 Letërsia shqipe, poezi

8Sh-2 Letërsia shqipe, drama

8Sh-31 Letërsia shqipe, romane etj.

Po ashtu dhe letërsia e huaj mund të ndahet sipas gjuhëve, sipas gjinive etj., p.sh.:

821.111 Letërsia angleze.

821.112.2 Letërsia gjermane

821.133.1 Letërsia franceze etj.

"Librat janë pasqyra: shikoni brenda tyre vetëm atë që keni brenda jush.

9 Gjeografia. Biografite. Historia.

Kjo degë ndahet në këto nëndarje:

91 Gjeografia. Eksplorimi i tokës dhe i vendeve të veçanta. Udhëtimet. Gjeografia rajonale.

929 Studime biografike.

93/99 Historia.

949.65 Historia e Shqipërisë

Shembull 1: Një degë kryesore e klasifikimit e ndarë në nënklasa:

8 - Gjuha. Gjuhësia. Letërsia



82 – Letërsia




821.18 - Letërsia shqipe



821.18-1 Poezia

- Literatura, e organizuar sipas vendosjes sistematike, është vendosur në raftet sipas renditjes alfabetike të autorëve, brenda degëve përkatëse. Megjithatë, përjashtohen nga ky rregull librat e shkruar nga më shumë se tre autorë, botimet kolektive (konferencat etj.), ku për bazë merret titulli i librit. Kombinimi i të dhënave të klasifikimit dhe të emrit të autorit ose të titullit, **përcakton vendndodhjen fizike të materialit në fond.**

Shembull 2: Botim me autor kolektiv (renditja në raft sipas titullit).



“leximi është një mënyrë tjetër për të qënë diku”

- Shënja e autorit dhe indeksi i klasifikimit shkruhen në formë thyese në këtë mënyrë: 821.18/A 14. Për letërsinë, për lehtësi shkrimi në etiketë nuk e shkruajmë me indeksin e plotë të klasifikimit por **8Sh** letërsia shqipe dhe letërsinë e huaj **8H**, standard i brendshëm, i vlefshëm vetëm në vendin tonë i vendosur nga Biblioteka Kombëtare.

Shembull 3: Numri i vendit – shifri i librit (pulla të ngjitura në libra):

UNIVERSITETI <u>“E.Çabej” Gjirokastrë</u>
8Sh-31
A 14
BIBLIOTEKA

UNIVERSITETI <u>“E.Çabej” Gjirokastrë</u>
94(496.5)
A 37
BIBLIOTEKA



“Kam 80 vjet që lexoj dhe akoma nuk u mësova të lexoj”. Gëte

KATALOGU COBISS/OPAC; RRJETI I SISTEMEVE BIBLIOTEKARE INFORMUESE DHE SISTEMEVE TË INFORMACIONIT

- Katalogu i bibliotekës është lista përshkruese e dokumenteve që posedon biblioteka si libra, periodikë, publikime etj.
- Ai lejon: **1)** kërkim të materialeve sipas standarteve bibliotekare (autorit, titullit, tematikës etj);
2) verifikon mundësinë e të paturit të veprës dhe lokalizon vendndodhjen në bibliotekë.
- Ky katalog quhet *kolektiv* pasi bën lidhjen e të dhënave të kataloguara me shumë biblioteka (të vendit dhe të huaja); shërben si një bazë e përbashkët të të dhënave të regjistrimeve të të gjitha bibliotekave që ndodhen në rrjetin COBISS.
- Për katalogimin e fondit në bibliotekën tonë është instaluar programi COBISS; është filluar nga katalogimi i librave, kryesisht shkencorë.
- Përdoruesi (studentë, staf akademik dhe çdo i interesuar jashtë Universitetit), ka akses të futet në katalogun on line të Bibliotekës nëpërmjet programit COBISS+ (OPAC), lehtësisht i aksesueshëm në ikonën e pasqyruar në desktopin e kompjuterave të Bibliotekës. Nga jashtë Bibliotekës, aksesin në programin COBISS+ e përftojme në faqen zyrtare të UGJ ose nëpërmjet aplikacionit QR CODE READER, i afishuar në ambientet e universitetit.



- o SHKARKONI NË SMARTPHONE APLIKACIONIN: “QR CODE READER”.
- o HAPNI APLIKACIONIN DHE SCANONI KODIN (FIGURËN E MËSIPËRME);
- o AUTOMATISHT DO TË KENI AKSES NË KATALOGUN ELEKTRONIK COBISS:

- Falë rrjetit që mundëson programi COBISS/OPAC, mund të kërkohet dhe të gjendet një literaturë e caktuar në bibliotekat e tjera.
- Pasurimi, korrigjimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave bëhet nga administratori i programit me qendër Maribor, Slloveni.


Biblioteka është një tryezë e shtruar e ideve. ku çdo njeri është ftuar dhe ku gjen atë vshqimm që kërkon; ajo është një magazinë rezervash. ku dija njerëz kanë vënë mendimet dhe zbulimet e tyre dhe të tjerët i bëjnë të dobishme për vete.”

Alexandër Hercen


Katalogu COBISS+ (OPAC) - Kërkimi.

COBISS+ është versioni i ri i aplikacionit COBISS/OPAC.

Jeni duke kërkuar një libër konkret në bibliotekë, po kërkonit materiale nga një fushë e caktuar dhe ju intereson të dini nëse ndodhet në bibliotekën e universitetit dhe nëse nuk është i disponueshëm këtu, në cilën bibliotekë të rrjetit mund të gjendet? Për këtë do ndjekim disa hapa. Fillimisht, në adresën <https://al.cobiss.net> - tek faqja e hapur klikon tek [COBISS+ \(kërkimi i materialit\)](#) (ose <https://plus.al.cobiss.net>) dhe do të arrijmë në këtë pamje:



Pamja vijuese do të jetë:



Bazat e të dhënave dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre.

Ç' kuptojmë me termin baza e të dhënave? Baza e të dhënave është koleksioni i të dhënave (katalogu). Në COBISS+ mund të kërkonit në *bazën/bazat lokale* të të dhënave të bibliotekave si dhe në *bazën e përbashkët* bibliografike të të dhënave - katalogun e përgjithshëm.

Baza lokale është, psh., vetëm katalogu i universitetit tonë ose i çdo biblioteke tjetër, si njësi më vete. Këto mund të gjenden duke hapur: [Lista e të gjitha bibliotekave](#) - që ndodhet në faqe, nga ku mund të përzgjedhim atë të interesuarën. Siç shihet dhe në ilustrimin më sipër, në rreshtin e dytë të shkrimit, duke shënuar "UGJ", kemi zgjedhur bazën lokale të universitetit tonë. Akronimet (inicialet) e çdo biblioteke, janë përcaktuar paraprakisht në program, ato mund të shihen të gjitha me hapjen e listës së bibliotekave. Mund të përzgjidhni disa biblioteka dhe në këtë mënyrë, kërkonit në disa katalogë njëherësh.

Baza e përbashkët bibliografike e të dhënave - katalogu COBIB. Kërkimi në bazën e të dhënave COBIB mundëson kërkimin e të dhënave në katalogun e përbashkët të të gjitha bibliotekave, universitare dhe publike, që janë anëtare të COBISS-it. Kjo bazë e të dhënave zakonisht përdoret për kërkime të përgjithshme.


Në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB, në bazat lokale të bibliotekave dhe bazat e tjera të të dhënave mund të përdorni një nga këto mënyra të kërimit:

1. Kërkimi i thjeshtë – shënoni fjalën ose frazën;
2. Kërkimi i avancuar – përdorni formularin për kërkim, përzgjidhni fushat për kërkim, të cilat mund të kombinohen.
3. Kërkimi i specializuar – ndërtoni pyetjen për kërkim me sintaksë të saktë, ku duhet të njihni strukturën e regjistrimeve bibliografike (kërkoni ndihmën e punonjësit të bibliotekës).


1. Kërkimi i thjeshtë.

- o Në dritaren për kërkim "*Pyetja për kërkim*" shënoni një ose disa fjalë.
- o Përzgjidhni katalogët e bibliotekave në të cilët dëshironi të kërkonit; (parametri i paracaktuar është kërkimi në katalogun e bazës lokale të të dhënave UGJ).
- o Kërkimin mund ta kufizoni me llojin e materialit; si parametër i paracaktuar është kërkimi për: * *të gjitha materialet* - që ndodhet në fund të dritares "*Pyetja për kërkim*". Llojet bazë të materialeve, për të cilat mund të kërkonit, janë: libra (monografite), serialet, artikujt, audio dhe videoregjistrimet, filmat, materialet hartografike, materialet muzikore, materialet grafike, lodrat – objektet, veprat e ekzekutuara.
- o Kërkimi fillon pasi të shtypni tastin *Enter* ose të klikoni butonin *KËRKO*.

Shembull:




- Në dritaren "Pyetja për kërkim" shënoni: *Kadare*. (dmth. çdo autor, titull, fjalë nga titulli etj.)
- nga lista në të djathtë përzgjidhni llojin e materialit, p.sh.: "*të gjitha regjistrimet*".
- Enter ose të klikoni butonin **KËRKO**.




Siç shihet, rezulton që, në bibliotekën tonë, universiteti "E. Çabej", ndodhen 47 regjistrime të shkrimtarit tonë të njohur, të shfaqura 10 regjistrime në një faqe. Rezultatet e kërkimit janë të renditura sipas vitit të botimit.

Nëse përsërisim të njëjtin kërkim, *Kadare*, por, në bazën e përbashkët të të dhënave, rezultati do të jetë mbi njëmijë regjistrime:




Kujdes!- këto janë rezultatet e gjetura në bazën e përbashkët të të dhënave, tek e cila kemi qasje thjesht duke e lënë bosh dritaren e dytë të shkrimit: "*Bibliotekat*", ku sistemi, automatikisht, është i lidhur drejtpërdrejt me bazën e regjistrimeve të të gjitha bibliotekave. Siç dallohet, aty, automatikisht, del shënimi me shkrimin e zbehtë: "*TË GJITHA BIBLIOTEKAT ...*"

Më lart, përmendëm që, në dritaren "*Pyetja për kërkim*", (ku udhëzohej të shënonit: *Kadare*), mund të shënojmë veç autorit edhe titullin, fjalë nga titulli etj. Për shembull:



Kërkojmë informacion për romanin "*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*" të Dritëro Agollit. Nëse do të përdornit si fjalë hyrëse mbiemrin e autorit, atëherë sistemi do të gjeneronte të gjitha regjistrimet e D. Agollit. Atëherë, duke qenë dhe titull relativisht i gjatë ose duke supozuar se, nuk e mbajmë mend të saktë titullin e plotë, mjafton të përdorim opsionin e futjes së një fjale nga titulli; shënojmë "*zylo*" (nuk ka rëndësi fillimi me shkronjë të madhe, duke qenë se është emër i përveçëm, pasi këtë e zgjidh automatikisht sistemi) dhe rezultojnë dy botimet e veprës:



Nëse klikoni mbi një rezultat të kërkimit, shfaqet regjistrimi me të dhëna të detajuara për materialin:

Universiteti 'Eqrem Çabej', Gjirokastër (UGJ)	
Të dhënat bazë Të dhënat e detajuara	
Autor - person	Agolli, Dritëro, 1931-
Titulli	Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo / Dritëro Agolli
Lloji i materialit	forma të tjera letrare
Gjuha	shqipe
Viti	1999
Botimi dhe prodhimi	Tiranë : Botimet Dritëro, cop. 1999
Përshkrimi fizik	464 f. ; 20 cm
Seria	Stinët ; 2
ISBN	9992734094 9789992734094
COBISS.AL-ID	1555043552

Përmes kërkimit të thjeshtë, kërkohet për të gjitha të dhënat. Është kërkimi i përdorur më së shumti, pasi përdoret kur të dhënat nuk dihen në mënyrë të saktë (p.sh. titulli, autori etj).

2. Kërkimi i avancuar.

Kërkimi i thjeshtë Kërkimi i specializuar

Autori Titulli Fjalët kyçe

të gjitha regjistrimet të gjitha gjuhët

UGJ - Universiteti 'Eqrem Çabej', Gjirokastër

KERKO

Kërko materialin në katalogun e përbashkët të bibliotekave të Shqipërisë. COBISS+ mund ta përdorin të gjithë: kërkuesit shkencorë, nxënësit, studentët, prindërit, profesorët, pensionistët... Më shumë...

Lista e të gjitha bibliotekave Bazat e tjera të të dhënave

Hyrja në Profilin COBISS


Shqip English

Pyetjen për kërkim ndërtojeni sa më saktë:


- Në dritaren për kërkim shënoni një ose disa fjalë. Në listën në të majtë përzgjidhni fushën për kërkim (indeksin për kërkim) për të kufizuar kërkimin.
- Nëse dëshironi të kërkoni me disa fusha, termat shënojnë edhe në dritaret e tjera për kërkim. Në listën në të majtë përzgjidhni fushën për kërkim (indeksi për kërkim) për të kufizuar kërkimin.

- Nëse gjatë kërkimit përdorni disa fusha për kërkim, duhet të keni kujdes në përzgjedhjen e operatorëve logjikë (DHE, OSE, JO) në listën në të djathtë.
- Përzgjidhni katalogët e bibliotekave në të cilët dëshironi të kërkoni.
- Sipas nevojës, përzgjidhni llojin e materialit, gjuhën ose materialin e disponueshëm në mënyrë elektronike.
- Kërkimi ekzekutohet kur të keni shtypur tastin Enter ose butonin **KËRKO**.


Lista në të majtë mundëson përzgjedhjen e fushës për kërkim (indeksin për kërkim) për të kufizuar kërkimin; klikojmë tek simboli "v", në fund të hapësirës së shiritit të dritareve (shih foton):



Nëse gjatë kërkimit përdoren disa fusha për kërkim, duhet të keni kujdes në përzgjedhjen e operatorëve logjikë (DHE, OSE, JO) në listën në të djathtë:




Fushat i shtojmë sipas nevojës duke klikuar tek shenja *plus* ("⊕"), që ndodhet midis dritareve me operatorët logjikë (DHE, OSE, JO) dhe butonit *KËRKO*:



Në ndryshim nga kërkimi i thjeshtë, kërkimi i avancuar, përveç autorit dhe titullit, ka një radhë elementësh të tjerë që mund të përdorim për gjetjen e materialeve. Ne do të ndalemi tek elementi "*Fjalët kyçe*", pasi është një element i rëndësishëm që mund të përdoret edhe tek kërkimi i thjeshtë.


Fjalët kyçe ose përzgjedhja e *termit për kërkim* ka një rëndësi të veçantë si mënyrë kërkimi. Një studenti i duhet një tekst universitar suplementar për të studiuar, një detyrë ose temë diplome, një pedagog që ka për të kryer një kërkim shkencor, sipas tematikës së studimit të tij, i duhet të hulumtojë dhe mbledhë literaturën e nevojshme. Në këto raste, kërkimi me fjalëkyçe është mënyra kryesore për të gjetur informacionin e duhur.

Gjetja e një materiali me anë të *fjalëkyçeve* të lejon të kërkosh në të gjitha fushat në katalogun e bibliotekës (termi "*fushat*", i përmendur në këtë rast, ka të bëjë me fushat dhe degët e shkencës sipas rregullave të përcaktuara në tabelën e klasifikimit universal).




Në të dhënat e detajuara të regjistrimit të mësipërm, tek fusha "*Terma lëndorë të pakontrolluar*" kemi fjalëkyçet: *shkencat mjekësore / mjekësia / gjinekologjia / obstetrika / infermieri / mami / tekste universitarë*. Siç vihet re, termat renditen duke shprehur fillimisht konceptin e gjerë të fushës, duke ardhur drejt "ngushtimit" të kuptimit të përmbajtjes së saj (fushës si shkencë).

Për të gjetur termat e duhur për fushat e ndryshme të shkencës, përveç termave kryesorë si: mjekësia, matematika, fizika, kimia, historia, biografia etj., duhet të konsultoheni me specialistët e bibliotekës, fjalorët terminologjikë të degëve të veçanta të shkencës, t'i referoheni manualit të tabelës së klasifikimit "*KDU & COBISS*" etj.




Rezultatet do të jenë 1037 regjistrime. Por nëse shtojmë një *fjalëkyç* me qëllim ngushtimin apo kufizimin e kërkimit, psh. *qelizore*, atëherë do të kemi 60 materiale mbi biologjinë qelizore:




Gjithashtu, për të kufizuar fushën e kërkimit dhe gjetur sa më saktë dhe shpejt materialin e nevojshëm, mund të përdorim: **a. operatorët logjikë (DHE, OSE, JO);**

b. përdorimin e filtrave (lista në të djathtë të faqes "rezultati i kërkimit")

a. Operatorët logjikë (DHE, OSE, JO) - me këtë mënyrë termat për kërkim mund të kombinohen përmes këtyre operatorëve. Për shembull, biologjia është një ndër shkencat bazë mbi të cilën zhvillohet mjekësia. Duke përdorur si fjalëkyç *biologji* e kombinuar me *mjekësi*-në, duke përdorur operatorin *DHE*, do të përftojme 14 rezultate:



Ndërsa, kur përdor operatorin *OSE*, po këto dy fjalëkyçe (*biologji* e kombinuar me *mjekësi*), do të përftojme 144 rezultate:




b. Përdorimi i filtrave (lista në të djathtë të faqes "rezultati i kërkimit")

Pas ekzekutimit të kërkimit ju merrni listën e rezultateve të kërkimit. Në anën e majtë shfaqet një menu-listë me etiketa, që mundësojnë shfaqjen në mënyra të ndryshme të rezultateve të kërkimit. Kjo menu (e faseteve) ofron klasifikimin e regjistrimeve që janë rezultat i kërkimit që ke kryer duke i filtruar ato sipas nevojës.

Përmbajtja e etiketave më të rëndësishme:

- lloji i përmbajtjes
- lloji i materialit
- gjuha
- kategoria e publikut
- autori
- viti i botimit
- përmbajtja, subjekti




Krahas përshkrimit të përmbajtjes, në kllapa shënohet edhe numri i rezultateve të kërkimit të fundit për çdo etiketë. Duke klikuar në vlerën e veçantë të etiketës (*libër* te etiketa *lloji i materialit*), pyetjen bazë për kërkim e plotësoni me kufizimin në vlerën e përzgjedhur të etiketës.


Duke përzgjedhur vlera të tjera të faseteve ju do të bëni kufizim shtesë të kërkimit (p.sh., si në figurën më poshtë, *tekst mësimor* nga etiketa *lloji i përmbajtjes* dhe numri i rezultateve: *më*

shumë (5...)). Me këtë mënyrë të kufizimit të kërkimit, ju u afroheni më shpejt dhe më pranë rezultateve që dëshironi.

Pasi të përzgjidhen me vlerën e dëshiruar, ato etiketa që duhen, klikojmë butonin *Konfirmo filtrat*, dhe presim rezultatin e kërkimit. Për të filluar një kërkim të ri, me butonin *Largo filtrat*, zerojmë vlerat dhe japim vlera të reja.




Një element tjetër i mënyrës së kërkimit është edhe nëpërmjet *gjuhës*. *Gjuha* e materialit na shfaqet që në dritaren e parë të kërkimit të avancuar tek fusha e fundit nga e djathta te dritarja e së cilës, me një klikim tek "v", del lista e gjuhëve nga ku mund të përzgjedhim të dëshiruarën:



Gjithashtu, gjuhën mund t'a përzgjedhim dhe nga lista e etiketave filtruese të kërkimit, ku etiketa *gjuha* ndodhet e katërta në renditje.

Në shembullin më poshtë, kemi përzgjedhur regjistrimet në gjuhën angleze në disipinën shkencore të matematikës -110 regjistrime:



3. Kërkimi i specializuar

Kërkimi i specializuar mundëson krijimin e pyetjeve të sakta për kërkim duke përdorur indeksat për kërkim (parashtesat ose prapashtesat) në kombinim me operatorët logjikë dhe ata të kontekstit. Ky lloj kërkimi përdoret nga përdoruesit më të përgatitur, të cilët njohin shumë mirë strukturën e të dhënave bibliografike.

Për më tepër, në lidhje me kërkimin e specializuar, por edhe për atë të thjeshtin dhe kërkimin e avancuar, biblioteka e universitetit tonë ka përpiluar një doracak të brendshëm të saj, me titull: "KDU & COBISS", në ndihmë të përdoruesve. Manuali përmban listën e përgjithshme të kodeve të Klasifikimit Dhjetor Universal (UDC) të përshtatur për kërkesat e sistemit COBISS dhe disa orientime e udhëzime praktike për përdorimin e programit.


Çdo kod (me numra) shoqërohet me përmbajtjen dhe kuptimin sipas KDU-së. Kjo e ndihmon përdoruesin për krijimin e saktë të fjalëve kyçe, përzgjedhjen e termit për kërkim, pra, në kuptimin e gjerë, në hartimin e saktë të pyetjeve për kërkim. Nga ana tjetër, duke u familjarizuar dhe shfrytëzuar kodet e KDU-së, përdoruesi do të arrijë saktësisht dhe më shpejt rezultatin e kërkimit.

Ashtu si numrat dhjetorë (kodet) të klasifikimit shtohen kur një material përmban informacion të detajuar të një dege të caktuar të shkencës, rrjedhimisht edhe përmbajtja e shprehur në fjalë do të zgjerohet në terma, sipas parimit të KDU-së, fillohet nga e përgjithshmja dhe shkohet tek e veçanta.

Ndaj, përdoruesi, me pasjen akses në tabelën e klasifikimit të përmbledhur posaçërisht nga programuesit e COBISS-it do ta ketë me të lehtë formulimin e saktë të termave për kërkim dhe gjetjen e shpejtë të literaturës për interesat e tyre studimore.

Për tu patur në vëmendje gjatë përdorimit të programit:

- *shkurtime*; po të shihni fotot, fjalëkyçet kanë në fund shenjën "*", e cila zëvendëson karaktere, gërma ku fjala mund të vijojë. Nëse shkruhet: *matematik**, në rezultatet e kërkimit do dalin edhe regjistrimet që e përmbajnë këtë fjalë në forma të ndryshme gramatikore si *matematikor, matematikë, matematike, matematika etj.*
- *emrat vetjakë*; te mënyra e kërkimit duhet të shënoni emrin në formën *Mbiemri, Emri*. Midis mbiemrit dhe emrit është presja dhe hapësira.
- *shkronjat e veçanta* (të të gjitha gjuhëve); ç, ë, ê, è, à, ì etj., sistemi i konverton automatikisht në *c, e, e, e, a, i* etj. (Rezultati i kërkimit nëse kërkojme me titull do të jetë i njëjtë: *Kështjella* me *Keshtjella*).
- *shkronjat e mëdha dhe të vogla*; në pyetjen për kërkim mund të përdorni shkronjat e mëdha ose të vogla. Rezultati do të jetë i njëjtë nëse kërkon: *Arapi, Fatos; arapi, fatos.*
- *nyjet në gjuhët e huaja*; *a, an, the* -në anglisht; *die, das* etj. -në gjermanisht; *l', la, le, les* etj. -për gjuhët latine; te mënyra e kërkimit me titull ose fraza, ju mund të mos i shënoni fare nyjet kur ato ndodhen në fillim të titujve.





“Sa e madhe habia ime kur ndjeva se, libri hapi para meje dritaren e një bote të re, të paparë, e cila më rrëfen për njerëzit, ndjenjat e mendimet, marrëdhëniet që unë nuk i kisha parë, nuk i dija”
Maksim Gorki

BURIME TË TJERA PËR GJETJEN E INFORMACIONIT ELEKTRONIK NË BIBLIOTEKË.

- Falë abonimit të Bibliotekës në revista shkencore, është e mundur nga ana e *studentëve/pedagogëve* të shfrytëzojnë literaturë on line, e cila është vetëm në gjuhë të huaj:
 1. American Mathematical Society: <https://mathscinet.ams.org/mathscinet/>
 2. International Association Universitites: <https://iau-aiu.net/>
 3. Trading Economics.com: <https://tradingeconomics.com/>
- Përdoruesit mund t'i gjejnë këto adresa të afishuara pranë kompjuterave të instaluar në ambientet e Bibliotekës.

Shembull 1: Shfletimi dhe shfrytëzimi në mënyrë elektronike e revistave shkencore.



“le të bëhemi të logjikshëm dhe të shtojmë një ditë të tetë në javën. dedikuar ekskluzivisht leximit”
lena Dunham

ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË NDRYSHME NGA BIBLIOTEKA AKADEMIKE.

- Në vazhdimësinë e punës së saj, Biblioteka Akadematike organizon aktivitete të ndryshme, meqënëse, qëllimi kryesor i saj është që të reklamohet si një hapësirë edukative, sociale dhe kulturore.
- Çdo vit të ri akademik planifikohet organizimi i aktiviteteve me tema të cilat ndihmesë kryesore kanë librin si dhe padyshim, motorët e kërkimit dhe informimit elektronik.
- Këto tema bëjnë të mundur pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve të degëve të studimit si me drejtim shoqëror edhe atë natyror, si ekspozita, konferenca, forume, projekte:

Shembull 1: Një tabelë tip për projektet:

1.	Titulli i Projektit:	Tematika: (përcaktim nëse projekti përbëhet nga një tematikë ose më shumë mbi të njëjtën temë)
2.	Lloji i Projektit: (konferencë, forum, ekspozitë..)	Periudha ose data e përcaktuar; Numri i seancave të takimeve:
3.	Përgjegjësi i Projektit:	Partnerët:
4.	Emrat e prezantuesve të Projektit:	Publiku i përcaktuar si pjesëmarrës në projekt
5.	Prezantimi i përgjithshëm: (koleksione ose vepra të përdorura) (një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes)	Qëllimet e Projektit:
6.	Vendndodhja:	Buxheti i parashikuar: (çmimi i projektit) (dhurimet e mundshme)

Shembull 2:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

AKTIVITET PROMOVUES ME RASTIN E 50 -VJETORIT TË KRIJIMIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"

KONFERENCË STUDENTORE ME PJESËMARRJEN E STUDENTËVE TË DEPARTAMENTIT TË HISTORISË DHE GJEOGRAFISË,
CIKLI I, BACHELOR DHE CIKLI II, MASTER ME TEMË: **KONTRIBUTI I FONDIT BIBLIOTEKAR NË AFTËSIMIN SHKENCOR TË
STUDENTËVE TË DEGËS HISTORI-GJEOGRAFI.**



Quand je pense à tous les livres qu'il me reste à lire, j'ai la certitude d'être encore heureux.

Jules Renard

***Pamje nga ekspozita "50 vjet Universiteti i Gjiroksatrës", hapur Ditën Botërore të Librit,
23. 04. 2018:***





Shembull 3: Ekspozitë me libra dhuratë, aktivitet sensibilizues për dhurimin e librit, shkurt, 2018:



A room without books is like a body without a soul.

SI KRYHET PASURIMI I FONDIT BIBLIOTEKAR?

- UGJ pasuron në mënyrë të vazhdueshme literaturën e Bibliotekës Universitare në varësi të nevojave për literatura të ndryshme. UGJ *parashikon fonde për blerjen* e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e çdo fakulteti dhe në varësi të mundësive financuese.
- Fondi i bibliotekës pasurohet shpesh edhe nga *dhurimet*.
- UGJ ndjek një politikë mbështetëse për *publikimet* e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe këtë e bën duke i publikuar në organin e vet “Kërkime Universitare”, me ISSN: 2226-082X. Të gjithë këta periodikë gjenden në Bibliotekë:

❖ **Periodiku shkencor “Kërkime Universitare”:**

“Matematika dhe Shkencat e Natyrës”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

“Shkenca Shoqërore, Ekonomike dhe të Edukimit”, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

❖ Numri total i periodikëve “Buletin Pedagogjik” dhe “Kërkime Universitare” të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë: **40**

❖ Numri i parë: me titullin “Buletin Pedagogjik”, viti i botimit: Shkurt **1989**,

❖ Numri i fundit: “Kërkime Universitare”, viti i botimit: **2015**;

❖ Numri i artikujve të botuar: **769** gjithsej; numri më i madh i revistave të botuara, i përket Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Ekonomike dhe të Edukimit.



SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS DHE FONDIT TË BIBLIOTEKËS.

- Shfrytëzimi i hapësirës dhe i fondit bibliotekar bëhet në mënyrë të vazhdueshme, nga studentë dhe pedagogë të Universitetit:


Orari: 08⁰⁰ - 19⁰⁰, (nga e hëna në të premte).



Ka krime më të këqija se djegia e librave: një prej tyre është të mos i lexosh.

Joseph Brodsky

Skicë-guidë e organizimit të fondit të librit në bibliotekë:



- Frekuentimi, sipas rregullores, pasqyrohet në mënyrë të përditshme, mujore dhe vjetore.

Shembull 1: Frekuentimi ditor

Studentë:	Ped. + Adm.:	Studentë:	Ped. + Adm.:	Studentë:	Ped. + Adm.:
Studentë:	Ped. + Adm.:	Studentë:	Ped. + Adm.:	Studentë:	Ped. + Adm.:
				Gjithsej: _____	

Shembull 2: Frekuentimi mujor

Nr.	DATA	PEDAGOGË	LITERATURË SHQIP	LITERATURË E HUAJ	STUDENTË	LITERATURË SHQIP	LITERATURË E HUAJ	ADMINISTRATA	LITERATURË SHQIP	LITERATURË E HUAJ
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										

Shembull 3: Frekuentimi vjetor

Nr.	Muaji	Studentë	Pedagogë	Nr. në total
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				

- Është e organizuar si një bibliotekë me fond gjysmë të hapur.



- Si një strukturë mbështetëse në mbarëvajtjen e procesit mësimor, biblioteka siguron shfrytëzimin e hapësirës dhe fondit të saj në ndihmë të praktikës profesionale për studentët e degës “Librar dhe bibliotekar”.



"Sot një lexues, nesër një drejtues"
Margaret Fuller